



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 412/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)
- II. URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin 2532D/01R
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit si në pikën –II- të këtij dispozitivit të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

**Arsyetim**

Me datë 27.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me numër 74 në të cilën thekson se 46 votat e tij i janë shënuar gabimisht kandidatit me numër 73. Këtë gabim sipas parashtruesit të ankesës e pranon edhe komisionari i vendvotimit 2532D/01R dhe si dëshmi ka bashkangjitur edhe FRK-në.

Bazuar në nenin 117.2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuara gjeti se:

**ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga Milazim Halitit kandidat për deputet nga subjekti politik LDK dhe

në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon se votat e tij se i janë regjistruar kandidatit tjetër nga subjekti politik LDK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2532D/01R e cila kuti ka qenë e mbyllur me 4 shirita anësor të sigurisë të cilët shirita kanë mbajtur këta numra: 135156, 113841, 135157 dhe 135158 si dhe me shiritin e sigurisë i cili gjendej ne mes të kutisë së votimit me numër 135155 e i cili shirit nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

Pas hapjes së kësaj kutisë së votimit në fjalë ka rezultuar se ka pas mospërputhje të votave të shënuar në FRK dhe atyre të cilat janë gjetur brenda kutisë së votimit.

Prandaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve të kandidatëve të subjektit politik LDK për këtë vendvotim.

PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 412/2014 më datën 30.06.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.